

VENDIM
Nr.459, datë 6.5.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE,
TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË BUJQËSISË,
USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT, PËR INSTITUTIN E SIGURISË
USHQIMORE DHE TË VETERINARISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe të Veterinarisë, sipas listës, me 1 (një) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministri i Brendshëm dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

1.FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Për inventarizimin e pronave të veçanta)

Institucioni i Pushtetit Qendror: MBUMK Bashkia / Komuna B / Tiranë (Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë) Fusha e përdorimit të pronës: Bujqësi – Ushqim (Administratë, kërkime shkencore)										
A			B				C			
Nr. rend.	Zona kadast. Indeksi i hartës	Nr. pasurisë	Lloji i pronës	Emri i pronës. Adresa	Sip. totale e pronës m ²	Nga sip. totale sa ndërtesë m ²	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/ enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/ enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (Shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	8120 Tr-GH-17,18 Tr-IJ-17,18	5/224	Ndërtesë+truall	Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, Rr.A Moisiu B/Tiranë	26410	3201	Administratë, kërkime shkencore	MBUMK	ISUV	Sipërfaqja totale e pronës + ndërtesat. (Detajuar si më poshtë)
		5/224-1	Ndërtesë+truall	Zyra administrate+laborator Shkencor, godinë 6-katëshe	706.4	510	Administratë, laborator shkencor	MBUMK	ISUV	
		5/224-2	Ndërtesë+truall	Dy godina dykatëshe, laborator etj.	790.0	651	Laborator etj.	MBUMK	ISUV	
		5/224-3	Ndërtesë+truall	Godinë dykatëshe e pa përfunduar	1018.0	874	Për kafshë eksperimentale	MBUMK	ISUV	
		5/224-4	Ndërtesë+truall	Klinikë veterinare, farmaci	213.0	160	Klinikë veterinare farmaci	MBUMK	ISUV	
		5/224-5	Ndërtesë+truall	Magazinë njëkatëshe	273.0	175	Magazinë	MBUMK	ISUV	
		5/224-6	Ndërtesë+truall	Godinë dykatëshe	505.5	428	Prodhim i viraleve	MBUMK	ISUV	
		5/224-7	Ndërtesë+truall	Godinë dykatëshe, izolator kafshësh	256.0	185	Izolator i kafshëve të infektuara	MBUMK	ISUV	
		5/224-8	Ndërtesë+truall	Hangar për bar të thatë	201.5	146	Hangar	MBUMK	ISUV	
		5/224-9	Ndërtesë+truall	Godinë njëkatëshe e pa përfunduar	93.0	58	Stallë kuajsh	MBUMK	ISUV	
		5/224-10	Ndërtesë+truall	Vendroje	24.0	14	Vendroje	MBUMK	ISUV	

